



Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 350/02 - 94211/24 dt. 19.07.2024 në emër të aplikuesit dhe pronarit Ilir Fetahaj nga Prishtina, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e 61 ndërtesave të banimit individual, të ndarë në 4 tipe të shtëpive Tipi 1, Tipi 2, Tipi 3, Tipi 4, të gjitha me etazhitet S+P+0, në kuadër të parcelave kadastrale nr. 252-0, 253-0, 255-0, 256-0 ZK Kolovicë të përfshira në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, në Prishtinë, në pjesën e destinuar “Zonë Banimi EKO”.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 28.01.2025 deri më 11.02.2025, në e-mail adresën: urbanizmi@rks-gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Zonë Banimi EKO Ndërtesa individuale banimore/shtëpi familjare, me etazhitet I –II min 50 max 100 ban/ha E propozuar: S+P+0;
b. Vija rregulluese	Sipas Planit Zhvillimor Urban
c. Vija ndërtimore	Sipas Planit Zhvillimor Urban
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	~ jo më pak se 5m për rrugë me gjerësi deri në 7m/5.00m’
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	~ 0.50-0.75 h veri-lindje ~ 0.50-0.75 h jug-lindje ~ 0.50-0.75 h veri-perëndim ~ 0.50-0.75 h jug-perëndim
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP = 0.1-0.2 ISHP ~ 0.2, e propozuar
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ = Përveç ISHP 10-20%, dhe shtigjeve për këmbësorë, pjesa tjetër gjelbërim ISHGJ ~ 70%, e propozuar
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN = 0.2-0.4 ISPN ~ 0.4, e propozuar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN = 60%, ISHPN ~ 10%, e propozuar
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	61 e propozuar
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	Guri dhe Druri
m. A ka qasje të pakufizuara në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
n. shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë me të madhe se sa zona për rreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentët që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari: